

RAPORTI NDËRKOMBËTAR I LIRISË FETARE PËR MAQEDONINË E VERIUT

Përmbledhje Ekzekutive

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon lirinë e fesë dhe shprehjen fetare. Ajo siguron barazi para ligjit për të gjithë individët, pavarësisht nga besimi fetar. Një nga amendamentet e kushtetutës përmend pesë grupe fetare të cilat automatikisht lirohen nga taksat dhe marrin përfitime të tjera: Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut (BFI), Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore dhe Bashkësia Hebreje. Grupet e tjera fetare duhet të regjistrohen për të marrë të njëjtat përfitime. Aplikimet për regjistrim nga Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (KOO), e lidhur me Kishën Ortodokse Serbe dhe Bashkësia Bektashiane (Tetovë), një grup sufist, mbetën pezull në Gjykatën Themelore II të Shkupit, edhe pas kërkesës së raportit të Komisionit Evropian (KE) të majit 2019 që qeveria të veprojë në pajtim me vendimet e mëparshme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe të rishikojë refuzimet e mëparshme të aplikimeve të këtyre grupeve. Komuniteti Bektashian (Tetovë) përsëri raportoi se pjesëtarët e tij ishin shqetësuar nga qeveria dhe BFI. BFI ka thënë se qeveria ka vazhduar ta favorizojë Kishën Ortodokse Maqedonase-Kryepeshkopata e Ohrit (KOM-KO), ndërsa grupet më të vogla fetare kanë vazhduar të raportojnë trajtim të pabarabartë të qeverisë krahasuar me pesë grupet e emërtuara në kushtetutë. Në shtator, Presidenti Stevo Pendarovski dhe Kryeministri Zoran Zaev dërguan letra publike përmes të cilave kanë kërkuar nga Patriarku Ekumenik Bartolomeu I i Konstandinopojës t'i japë KOM-KO-së autoqefali, veprime të cilat KOO i ka karakterizuar si ndërhyrje të qeverisë në çështjet fetare. Më 10 mars, qeveria miratoi definicionin e punës së Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) të vitit 2013 mbi mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit. Më 7 shkurt, partia politike qeverisëse Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë (LSDM), në përgjigje të deklaratave antisemitike në mediat sociale, dënoi "të gjitha format e gjuhës së urrejtjes, antisemitizmin, ose çfarë do lloj poshtërimi ose diskriminimi tjetër të drejtpërdrejtë ose indirekt të individëve dhe grupeve".

Komuniteti Bektashian (Tetovë) vazhdoi të kundërshtojë pretendimet e BFI-së për pronësi të plotë dhe planet e saj për të rinovuar teqenë Harabati Baba, një kompleks që Komuniteti Bektashian (Tetovë) e përdor si selinë të veten. Media raportoi disa incidente të vjedhjes, ndërsa qeveria raportoi një incident vandalizmi mbi varrezat ortodokse, krahasuar me 12 akte vjedhjeje ose vandalizmi të lokacioneve ortodokse në 2019. Qeveria raportoi gjithashtu një vjedhje në një xhami. Në janar, Komuniteti Hebre dhe Fondi i Holokaustit në mediat sociale së

bashku dënuan gjuhën e urrejtjes dhe komentet antisemitike. Në maj, Komuniteti Hebre raportoi tek autoritetet postime të shumta antisemite dhe gjuhë të urrejtjes nga një grup në Facebook i quajtur "Ninurta Macedonia". Hetimet mbetën pezull deri në fund të vitit.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës amerikane u takuan me përfaqësues të qeverisë për të diskutuar çështje të lirisë fetare, përfshirë bashkëpunimin e përmirësuar ndërfaqësor si dhe respektimin dhe trajtimin e barabartë të grupeve fetare nga ana e qeverisë. Zyrtarët e ambasadës u takuan me përfaqësuesit e grupeve të pakicave fetare, duke përfshirë Komunitetin Bektashian (Tetovë), Hebrejtë dhe Metodistët Ungjillorë.

Seksioni I. Demografia Fetare

Qeveria e SHBA vlerëson se popullsia e përgjithshme numron 2.1 milion (vlerësimi i mesit të vitit 2020). Sipas regjistrimit të fundit shtetëror, të vitit 2002, 65% e popullsisë i përket besimit të krishterë ortodoks, ndërsa 33% mysliman. Shumica dërrmuese e muslimanëve janë sunitë. Ekziston një numër i vogël i grupeve sufiste, duke përfshirë disa urdhra bektashianë. Gjithashtu sipas regjistrimit shtetëror, grupe të tjera fetare që së bashku përbëjnë më pak se 2 përqind të popullsisë, përfshijnë katolikët, konfesionet e ndryshme protestante, Dëshmitarët e Jehovait dhe Kishën e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Komuniteti hebre vlerëson se ka afërsisht 200 anëtarë.

Shumica e të krishterëve ortodoksë jetojnë në rajonet qendrore dhe juglindore. Shumica e muslimanëve jetojnë në pjesën veriore dhe perëndimore të vendit. Ekziston ndërlidhje mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e të krishterëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, ndërsa shumica e muslimanëve janë shqiptarë etnikë. Shumica e romëve dhe të gjithë turqit dhe boshnjakët janë myslimanë, ndërsa shumica e serbëve dhe vllahëve janë të krishterë ortodoksë. Ekziston gjithashtu një korrelacion midis përkatësisë fetare dhe politike, pasi partitë politike janë kryesisht të ndara përgjatë vijave etnike.

Seksioni II. Gjendja e respektimit të lirisë fetare nga ana e Qeverisë

Kuadri Ligjor

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe siguron barazinë e të drejtave për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga besimi fetar. Ajo garanton lirinë e fesë dhe të drejtën e individëve për të shprehur besimin e tyre lirisht dhe në publik, në mënyrë individuale, ose me të tjerët. Kushtetuta mbron gjithashtu identitetin fetar të të

gjitha bashkësive. Sipas Kushtetutës kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të zbatohet për bindjen personale, ndërgjegjen, mendimin ose rrëfimin fetar. Një ndryshim i kushtetutës përmend pesë grupe fetare që janë të liruara nga taksat dhe kanë përfitime të tjera: Kisha Ortodokse Maqedonase, BFI, Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore dhe Komuniteti Hebre. Ajo përcakton që këto pesë grupe, si dhe grupet e tjera të regjistruara, janë të ndara nga shteti, të barabarta para ligjit dhe të lira për të krijuar shkolla, organizata bamirësie dhe institucione të tjera shoqërore. Ligji mundëson që organizatat e tjera fetare t'i kenë të drejtat e njëjta dhe statusin ligjor si këto pesë grupe duke aplikuar për njohje nga Qeveria dhe regjistrim përmes gjykatës. Kushtetuta i ndalon partitë politike apo shoqatat e tjera që të nxisin urrejtje ose jotolerancë fetare.

Ligji përkufizon krimet e urrejtjes si vepra penale kundër një personi, personi juridik, ose personave dhe pronës, të kryer për shkak të një karakteristike të vërtetë ose të supozuar, përfshirë kombësinë, origjinën etnike dhe fenë ose besimin e viktimës. Gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes janë vepra penale të dënueshme dhe mund të rezultojnë me dënime më të ashpra për krime të tjera kur përfshihen elementë të krimit të urrejtjes. Dënimet variojnë nga një deri në 10 vjet burg dhe minimumi prej 10 vjet burg për krime të urrejtjes që çojnë në vdekje.

Organizatave fetare mund të kërkojnë të regjistrohen si "kishë", "bashkësi fetare" ose "grup fetar". Këto klasifikime bazohen në madhësinë e grupit, organizimin e brendshëm dhe hierarkinë e brendshme. Ligji i trajton këto tre kategori në mënyrë të barabartë, duke iu dhënë të njëjtat të drejta, përfitime dhe detyrime ligjore. Qeveria njih 38 organizata fetare, duke përfshirë edhe ato pesë të përmendura në kushtetutë. Ka gjithsej 18 kisha, 10 bashkësi fetare dhe 12 grupe fetare. Pasi të jetë regjistruar, një kishë, një bashkësi fetare ose një grup fetar lirohet nga taksat dhe ka të drejtë të aplikojë për kthimin e pronës të nacionalizuar gjatë epokës komuniste, për projektet e financuara nga qeveria dhe për lejet e ndërtimit për ruajtjen e vendeve të shenjta dhe vendeve kulturore. Ajo gjithashtu mund të themelojë shkolla. Mosregjistrimi nuk e pengon grupin fetar të mbajë takime ose të predikojë, por e pengon grupin të angazhohet në aktivitete të caktuara, siç janë krijimi i shkollave ose marrja e donacioneve që janë të zbritshme nga tatimi për donatorin.

Gjykata Themelore Shkupi II i pranon aplikimet për regjistrim dhe në afat prej 15 ditë pune duhet të vendosë nëse aplikimi i organizatës fetare i përmbushë kriteret ligjore për regjistrim. Kriteret në fjalë janë prania fizike administrative në vend, shpjegimi i besimeve dhe praktikave që e dallojnë atë prej organizatave tjera fetare, dhe emri dhe simboli i veçantë zyrtar i grupit. Një organizatë aplikuese duhet gjithashtu të identifikojë një organ mbikëqyrës përgjegjës për menaxhimin e financave të saj dhe të paraqesë kategorizimin e mjeteve financiare të saj dhe

burimeve të financimit si dhe procesverbalin e kuvendit themelues të organizatës. Ligji e lejon regjistrimin e më tepër grupeve të fesë së njëjtë. Krerët ose përfaqësuesit ligjor të grupeve fetare të regjistruara të jenë shtetas të vendit.

Gjykata ia dërgon aplikacionet e aprovuara Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), një organ qeveritar përgjegjës për nxitjen e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet qeverisë dhe grupeve të regjistruara fetare, i cili shton organizatat në Regjistrin e tij. KMBFGR nuk ka qasje ose mundësi për të ndikuar në procesin e regjistrimit. Nëse kërkesa refuzohet nga gjykata, organizata mund të ankimojë vendimin në Gjykatën e Apelit. Nëse Gjykata e Apelit hedh poshtë kërkesën, organizata mund të paraqes kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Gjykatën Kushtetuese, gjykata më e lartë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend. Në qoftë se kërkesa refuzohet nga Gjykata Kushtetuese, organizata mund t'i ankohet GjEDNJ-së.

Ligji nuk i lejon grupet fetare të drejtojnë shkolla fillore private fetare, por e parashikon këtë mundësi në nivel të shkollimit të mesëm dhe të lartë. Shkollat e mesme fetare përdorin kurrikulën e tyre dhe nuk i nënshtrohen certifikimit të Ministrisë së Arsimit. Studentët në shkollat e mesme fetare nuk lejohen të marrin provimin e detyrueshëm të maturës kombëtare dhe prandaj nuk mundtë regjistrohen në universitete. Ministria kërkon që studentët e klasës së gjashtë dhe më lart të marrin një prej tre lëndëve zgjedhore, dy prej të cilave kanë përmbajtje fetare: Hyrje në religjione dhe etika në religjion. Sipas përkrahimit të Ministrisë, këto lëndë mbulojnë fenë në mënyrë akademike, jofetare. Priftërinjtë ortodoksë ose hoxhallarët, në varësi të kërkesës nga prindërit dhe nxënësit, zakonisht mbajnë orë, me pëlqimin e ministrisë, dhe shteti paguan pagat e tyre. Ministria e Arsimit kërkon që të gjithë mësimmësuesit e këtyre lëndëve të marrin trajnim nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë ku ligjërojnë profesorë të filozofisë ose sociologjisë. Nëse nxënësit nuk dëshirojnë të zgjedhin një lëndë mbi fenë, mund të zgjedhin opsionin e tretë, Kultura klasike e qytetërimit evropian.

Të gjithë të huajt që kërkojnë të hyjnë në vend për të kryer aktivitete fetare ose rite fetare, duhet të marrin vizë pune para mbërritjes, një proces që normalisht zgjat rreth katër muaj. KMBFGR mban një regjistër për të gjithë punonjësit e huaj fetarë dhe organe të ndryshme qeveritare kanë autoritetin që t'ua miratojnë ose refuzojnë të drejtën për të kryer punë fetare brenda vendit. KMBFGR lëshon miratimet për leje qëndrimi të përkohshme dhe/ose kërkesa për viza pune për misionarë dhe punëtorë fetarë në emër të kishave të regjistruara, bashkësive fetare dhe grupeve fetare, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale verifikon që ato nuk shkelin ligjet e punës të vendit, dhe Ministria e Brendshme shikon aspektet e sigurisë. Grupet e

paregjistruara mund të kërkojnë leje pune dhe viza përmes procedurës së zakonshme. Vizat e punës janë të vlefshme për gjashtë muaj, me mundësi për zgjatje edhe për gjashtë muaj të tjerë. Rinovimet e mëvonshme të vizave janë të vlefshme për një vit. Nuk ka kufi për numrin e rinovimeve të vizave për të cilat mund të aplikojë një punonjës fetar. Klerikët dhe punonjësit fetarë nga grupe të paregjistruara kanë të drejtë të marrin viza.

Vendi është palë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Praktikat e Qeverisë

Deri në fund të vitit, Gjykata Themelore II e Shkupit nuk kishte ndërmarrë veprime në përputhje me raportin e plotë të KE-së së majit 2019, i cili i bëri thirrje qeverisë të zbatojë vendimet e mëparshme të GJEDNJ-së duke respektuar të drejtat e KOO-së dhe Komunitetit Bektashian (Tetovë). Në vitin 2017, GJEDNJ solli vendimin se qeveria kishte shkelur Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) duke refuzuar aplikimin e mëparshëm të KOO-së për statusin e grupit fetar. Në vitin 2018, GJEDNJ solli një vendim të ngjashëm në lidhje me Komunitetin Bektashian (Tetovë). *Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2020*, i botuar në tetor, theksoi se Maqedonia e Veriut duhej të zbatonte vendimin e GJEDNJ-së të vitit 2018.

Megjithëse qeveria në vitin 2019 ia pagoi KOO-së kompensimin prej 9,500 euro (11,700 dollarë) për dëmet dhe tarifatat gjyqësore siç kërkonte vendimi i GJEDNJ-së i vitit 2017, autoritetet e KOO-së vazhduan të deklarojnë se qeveria kishte refuzuar ta regjistronte grupin, se kishte ndërhyrë në punën e gjyqësorit në rastet që përfshinin KOO-në, dhe se kishte ushtruar presion mbi KOO-në për të ri-aplikuar për regjistrim me një emër të ri. KOO citoi një letër nga Gjykata Themelore II e Shkupit në shkurt ku kërkohej që KOO të ndryshonte emrin e saj sepse gjykata nuk mund ta dallonte atë nga KOM-KO. Në fund të vitit, kërkesa për regjistrimin e KOO-së nga viti 2009, pa ndryshim të emrit, mbeti pezull pranë Gjykatës Themelore II të Shkupit.

Qeveria ia pagoi kompensimin Komunitetit Bektashian (Tetovë) në qershor 2019 për dëmet dhe tarifatat gjyqësore siç kërkohej në vendimin e GJEDNJ-së nga viti 2018, por nuk ndërmori asnjë veprim tjetër në vitin 2020. Kërkesa për regjistrimin e këtij grupi e vitit 2010 mbeti pezull në Gjykatën Themelore II të Shkupit deri në fund të vitit.

Sipas zyrtarëve qeveritarë, vendimet e GJEDNJ-së nuk ndryshuan kushtin ligjor të vendit që emri i një aplikuesi të ishte i ndryshëm nga një grup fetar tashmë i regjistruar, prandaj Komuniteti Bektashian (Tetovë) dhe KOO duhej të ndryshonin ose modifikonin emrat e tyre për t'u regjistruar në gjykatë. Sipas këtyre zyrtarëve, Komuniteti Bektashian (Tetovë) mbeti i paregjistruar, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve të pazgjidhura pronësore me BFI-në, ndërhyrjes së BFI-së në gjykata dhe për shkak se dy komunitete të tjera bektashiane ishin regjistruar tashmë, të dyja në Kërçovë. Zyrtarët thanë në rastin e KOO-së se regjistrimi nuk ishte i mundur sepse ai preferonte të vepronte nën juridiksionin e Kishës Ortodokse Serbe dhe nuk do të pranonte heqjen e "KO" nga emri i saj, gjë që për KOO-në kishte rëndësi historike.

Gjykata Themelore II e Shkupit i ofroi KOO-së mundësinë që të riaplikojë me një emër të ri në muajin shkurt dhe Komunitetit Bektashian (Tetovë) në mars. Të dy aplikuesit nuk pranuan të shqyrtojnë mundësinë e ndryshimit të emrit dhe i kërkuan gjykatës të zbatojë vendimet përkatëse të GJEDNJ-së. Nuk pati zhvillime të reja në asnjërin nga dy rastet deri në fund të vitit.

Në mars, Gjykata Themelore II e Shkupit refuzoi kërkesën e Komunitetit Bektashian (Tetovë) për të rishikuar kërkesën e tij të regjistrimit, bazuar në vendimin e GJEDNJ-së në prill 2018. Në vendimin e gjykatës në tetor 2018 thuhej se Komunitetit Bektashian (Tetovë) i jepet një afat prej 30 ditësh për të paraqitur një kërkesë të re regjistrimi nën një emër të ndryshëm nga ai i dy grupeve të regjistruara bektashiane (në Kërçovë). Komuniteti Bektashian (Tetovë) refuzoi dhe i kërkoi gjykatës që në vend të kësaj të zbatonte vendimin e GJEDNJ-së. Gjykata gjithashtu i dha Komunitetit Bektashi (Tetovë) afat deri më 15 dhjetor 2019, për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm dhe për të informuar gjykatën për negociatat e tij me qeverinë në lidhje me zbatimin e vendimit të GJEDNJ-së, gjë që Komuniteti Bektashian (Tetovë) nuk pranoi të bënte.

KOO dhe Komuniteti Bektashian (Tetovë) thanë se, si komunitete të paregjistruara, ato vazhduan të përballen me diskriminim dhe frikësim, si mohim të statusit të të liruuarit nga taksat, pamundësi për të organizuar shkollat e tyre dhe komente nënçmuese për to në mediat sociale. KOO vazhdoi të akuzonte qeverinë për paragjykim ndaj saj dhe për mosrespektim të së drejtës së brendshme dhe ndërkombëtare.

Në qershor, Kreu Botëror i Komunitetit Bektashian, Baba Dede Edmond Brahimaj, i bëri thirrje qeverisë që të veprojë menjëherë për të adresuar shkeljen e të drejtës së Komunitetit Bektashian (Tetovë) për besim fetar dhe pronë, duke kërkuar që qeveria e Kryeministrit të përkohshëm Oliver Spasovski të zbatojë (ose

të veprojë në përputhje me) vendimin e GJEDNJ-së të prillit të vitit 2018 që kërkonte regjistrimin e Komunitetit Bektashian (Tetovë).

Në janar, KOO e quajti "të papranueshëm dhe të pabazë" vendimin e Gjykatës së Lartë të dhjetorit 2019 që hodhi poshtë kërkesën e saj për një rishikim të jashtëzakonshëm të vendimit të Gjykatës Penale të shkurtit 2017 kundër Peshkopit të shkarkuar nga detyra priftërore Jovan Vranishkovski dhe dy të tjerëve për pastrim parash. Gjykata Supreme konstatoi se Vranishkovski kishte pastruar dhe shpenzuar 8.6 milion denarë (172,000 dollarë) dhe se prona e blerë me ato para kishte mbetur në posedim të KOM-KO sepse Vranishkovski ishte pjesëtar i KOM-KO në kohën e blerjes. Në shkurt 2017, Gjykata Penale në Shkup dënoi Vranishkovskin me 13 muaj burg dhe dy të tjerë me dy vjet dënim me kusht. Gjykata e apelit mbështeti vendimin e gjykatës penale. KOO deklaroi se vendimi ishte rezultat i paragjyqimit të qeverisë.

Në mars, KOO tha se mediat kishin censuruar përfaqësuesit e saj sepse kishin thënë se angazhimi i qeverisë për autoqefalinë e KOM-KO-së, të cilën ajo filloi ta kërkonte në vitin 2018, përfaqësonte ndërhyrje politike në çështjet fetare në kundërshtim me karakterin laik të vendit. Për më tepër, zyrtarët e KOO-së thanë se familjarët e tyre ishin diskriminuar padrejtësisht në procedurat burokratike për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të udhëtimit.

Gjatë vitit, Gjykata Themelore II e Shkupit pranoi dhe miratoi tri kërkesa të reja për regjistrim. Në qershor, ajo regjistroi "Bashkesinë e Ehli Sunetit dhe Xhematit", me seli në Kumanovë dhe e drejtuar nga Sadulla Bajrami, një predikues të cilin shumë sunitë e konsideronin kontrovers sepse sipas tyre ai mbështeste ISIS-in, të cilën KMBFGR e shtoi në regjistrin e tij. Në dhjetor, e njëjta gjykatë regjistroi dy grupe: Grupin Qadiriyya Badawi "Zakaria", me seli në Kumanovë dhe Bashkësinë Islame Selefije "Dar al-Hadith", me seli në Shkup.

Për të nëntin vit me radhë, Komuniteti Bektashian (Tetovë) ka denoncuar në polici veprime ngacmimi nga individë që pushtuan kompleksin Harabati Baba Teqe në Tetovë si pjesë e një kontesti pronësie me BFI-në. Policia ishte ende duke hetuar në fund të vitit. Komuniteti Bektashian (Tetovë) deklaroi se këta individë vodhën pajisje dhe enë kuzhine nga selia e tyre në Tetovë në prag të festës së pranverës së Sulltan Nevruzit më 22 mars.

Më 19 maj, Kryetari i Komunës së Gostivarit Arben Taravari i dha Myftiut të BFI-së të Gostivarit, Shaqir Fetahu, akte të legalizimit të pronës për 28 godina fetare islame brenda komunës, përfshirë dy *teqe* (faltore) të komunitetit Bektashian (Tetovë), të dyja në fshatin Vrutok. Komuniteti Bektashian (Tetovë) tha që

dorëzimi i akteve pronësore për *teqet* BFI-së, në vend se komunitetit Bektashian (Tetovë), ishte "i padrejtë".

BFI deklaroi se qeveria e kishte trajtuar atë si "armikun e saj", dhe kishte favorizuar KOM-KO duke zbatuar "drejtësi selektive". BFI tha se qeveria kishte rikthyer më pak se 30 përqind të pronës që shteti ia kishte konfiskuar para se të fitonte pavarësinë në vitin 1991. Ndër pronat e kontestuara ishte Xhamia Husamedin Pasha në Shtip, e nacionalizuar në vitin 1955.

BFI deklaroi se qeveria vazhdoi të refuzonte lejen e ndërtimit për një xhami në fshatin Llazhec me përbërje të përzier etnike dhe fetare dhe se ajo vazhdoi t'i mohonte lejen për rindërtimin e një xhamie në Strumicë si dhe të xhamisë qendrore në Prilep me arsyetimin se ato ishin monumente kulturore nën jurisdikcionin e qeverisë, jo të BFI-së.

Në korrik, BFI deklaroi se qeveria e kishte favorizuar KOM-KO-në duke i dhënë asaj privilegje të posaçme, siç janë ofrimi i pronave publike pa pagesë dhe mjeteve financiare për ndërtimin e kishave të reja ortodokse.

KOM-KO deklaroi se komuna e Strugës ende nuk kishte vendosur mbi një kërkesë, në pritje që nga viti 2013, për ndërtimin e një kisha ortodokse në fshatin Oktisi.

Grupet më të vogla fetare vazhduan të pohojnë se qeveria i ka trajtuar ato në mënyrë të pabarabartë dhe ka favorizuar grupet fetare të renditura në kushtetutë mbi të tjerët. Ata thanë se Kryeministri Zaev, Presidenti Pendarovski dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë shpesh takoheshin vetëm me pesë grupet e njohura me kushtetutë.

Më 24 shtator, Kryeministri Zaev u takua me Kryepeshkopin Stefan dhe një delegacion të KOM-KO për të diskutuar përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar autoqefalinë e KOM-KO, një kërkesë të cilën Patriarku Ekumenik Bartolomeu I filloi ta shqyrtojë në vitin 2018. Zaev shprehu mbështetje dhe gatishmëri për të inkurajuar institucionet qeveritare të përfundojnë denacionalizimin e pronës së Kishës dhe të mbrojnë trashëgiminë e saj kulturore. Delegacioni falënderoi Zaev-in për letrën e tij dërguar Patriarkut Ekumenik, në shtator, si dhe për mbështetjen për autoqefalinë e KOM-KO. Në janar, ish-kryeministri i përkohshëm Spasovski dhe më pas ish-kryeministri Zaev u takuan me Patriarkun Ekumenik, ndërsa në shtator Presidenti Pendarovski dhe Kryeministri Zaev i dërguan letra publike duke kërkuar që t'i jepte autoqefalinë KOM-KO-së. KOM e karakterizoi këtë si ndërhyrje të qeverisë në çështjet fetare.

Më 21 shtator, parlamenti ndryshoi Ligjin për arsimin e mesëm; megjithatë, çështjet në lidhje me certifikimin e shkollave të mesme fetare, provimet e maturës dhe mundësinë e nxënësve që mbarojnë këto shkolla për t'u regjistruar në universitetet e vendit mbetën të pazgjidhura deri në fund të vitit.

Disa grupe fetare, prindër dhe zyrtarë të Ministrisë së Arsimit deklaruan se priftërinjtë ortodoksë dhe hoxhallarët të punësuar për të ligjeruar mësimet bazë për fenë dhe etikën shpesh gjatë punës vendosin theksin mbi praktikimin e feve të tyre në vend që të paraqisnin një pasqyrë neutrale të besimeve të ndryshme.

Më 10 mars, qeveria miratoi definicionin e punës të IHRA-s të vitit 2013 mbi mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit. Qeveria ngarkoi Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITSH) për të përkthyer, brenda tre muajsh, *"Rekomandimet për nxënien dhe mësimin në lidhje me Holokaustin"* të IHRA nga dhjetori 2019 në maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht për t'u shpërndarë në shkollat anembanë vendit.

Në qershor, ITSH filloi një kurs trajnimi katër-ditor në internet mbi edukimin rreth Holokaustit për 45 mësime të shkollave fillore dhe të mesme nga i gjithë vendi, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punëve të Jashtme të Izraelit dhe Qendrën përkujtimore botërore të Holokaustit në Jeruzalem – Yad Vashem. Ministri i Arsimit dhe Shkencës Arbër Ademi theksoi rëndësinë e partneritetit dhe edukimit në lidhje me Holokaustin në Ballkan dhe vuri në dukje se kjo ngjarje ishte pjesë e strategjisë për të përfshirë edukimin rreth Holokaustit brenda sistemit zyrtar arsimor shtetëror si dhe për të siguruar mjete për ta zbatuar atë.

Më 6 janar, krerët e partive politike dënuan komentet antisemitike të bëra në mediat sociale nga Vidana Boshkova Micevska, e afërt me partinë politike në pushtet LSDM-në, kundër Ministres së përkohshme të Punës dhe Politikës Sociale dhe pjestare të Komunitetit Hebre Rashela Mizrahi. Micevska shkroi në Facebook, "Nuk më shqetëson që Rashela u bashkua me një parti fashiste. Jam e sigurt se edhe nazistët kishin hebrenj që luftuan për të drejta më të mira për hebrenjtë." Më 7 janar, atëherë ish-kryeministri Zaev u përgjigj në Facebook, duke deklaruar se përdorimi i shtuar i fyerjeve në mediat sociale ishte "i papranueshëm në çdo shoqëri demokratike". Ai u bëri thirrje anëtarëve dhe mbështetësve të LSDM që "të jenë të përgjegjshëm dhe të përmbahen nga gjuha e urrejtjes, racizmi dhe ksenofobia, si dhe çdo fjalim që mund të perceptohet si antisemitik".

Media gjerësisht shpërndanë tweet-in antisemitik të gazetarit Branko Triçkovski më 6 shkurt për Mizrahin, në të cilin Triçkovski kishte thënë se Mizrahi "ha humus që bëhet nga hebrej të vdekur". Më 7 shkurt, Ministria e Brendshme deklaroi se kishte njoftuar Prokurorinë Themelore Publike në Shkup për incidentin. Në një postim më 7 shkurt në Facebook, LSDM dënoi "të gjitha format e gjuhës së urrejtjes, antisemitizmin, ose çdo poshtërim ose diskriminim tjetër direkt ose indirekt të individëve dhe grupeve". Qeveria nuk ngriti asnjë padi në lidhje me incidentin.

Më 18 Mars, qeveria shpalli gjendje të jashtëzakonshme 30-ditore dhe më 21 mars, vendosi orë policore në mbarë vendin për të penguar përhapjen e KOVID-19. Autoritetet ndërmorën një sërë masash për të kufizuar tubimet masive, të cilat patën ndikim mbi grupet fetare. Disa grupe fetare kundërshtuan kufizimet e qeverisë. Më 18 prill, një grup prej diku 100 besimtarë ortodoksë injoruan kufizimet dhe u mbledhën në Manastirin Bigorski për të festuar Pashkët.

Më 7 maj, BFI bëri publike planet e saj për të rihapur xhamitë që nga 12 maji për shkak të zvogëlimit të numrit të rasteve me KOVID-19. Më 10 maj, BFI ndërmori masa parandaluese për besimtarët, duke përfshirë dezinfektimin e xhamive, kufizimin e predikimeve në 10 minuta dhe ndalimin e tubimeve para ose pas faljeve. Më 9 maj, qeveria i bëri thirrje BFI-së të rishikojë vendimin e saj për të rihapur xhamitë dhe përmes një njoftimi për shtyp u bëri thirrje bashkësive fetare të përmbahen nga organizimi i ndonjë tubimi. Më 7 maj, qindra besimtarë ortodoksë u tubuan në një procesion në Strugë për të festuar Ditën e Shën Gjergjit, në kundërshtim me masat që ndalojnë tubimet.

Qeveria u bëri thirrje Kryepeshkopit të KOM-KO Stefan dhe Reisit të BFI Rexhepi të shprehin shqetësimet e tyre në lidhje me procesionin fetar të 7 majit në Strugë dhe njoftimin e BFI-së për të rihapur xhamitë dhe i ftoi ata t'u bënin thirrje besimtarëve që të vepronin me përgjegjësi si dhe të dënonin çdo sjellje që shkelte masat qeveritare. BFI, megjithatë, rihapi xhamitë më 12 maj. Thuhet se qeveria shmangu ballafaqimin me BFI në lidhje me mosrespektimin e kufizimeve të KOVID-19 sepse policia nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të parandaluar procesionin e Strugës dhe qeveria nuk donte të fitohej përshtypja se ajo favorizonte një grup fetar kundërshtues tjetër. Burimet deklaruan se qeveria ishte e gatshme të ndërmernte ndonjë veprim pasi policia nuk e parandaloi litaninë në Strugë dhe se kjo ndoshta ishte për të shmangur perceptimin se ajo ishte e njëanshëm në favor të KOM-KO.

Më 4 qershor, Prokuroria Publike e njoftoi shtypin se në bazë të informacionit publik kishte hapur një lëndë kundër Peshkopit të Eparkisë së Povardaries

Agatangel

sepse

publikisht

u kishte bërë thirrje besimtarëve ortodoksë nga qytetet dhe komunat e Velesit, Kavadarit, Negotinës dhe Gjevgjelisë për të vizituar kishat dhe varrezat për Rrëshajat, përkundër kufizimeve të KOVID-19 që kishte vendosur qeveria për tubimet masive.

Seksioni III. Gjendja me respektimin shoqëror të lirisë fetare

Zyrtarët e KOO thanë se ata dhe familiarët e tyre shpesh ishin në shënjestër të fyerjeve në media dhe viktime të sulmeve fizike nga individë që konsideroheshin të afërt me KOM-KO. Sipas mediave, në tetor, personeli i varrezave në Shkup-Gjorçe Petrov kishte refuzuar kërkesën e një familjeje që një prift i KOO të kryente shërbimet funerale dhe në vend të kësaj kishte kërkuar të dërgonin një prift të KOM-KO. Kur një gazetar pyeti pse e kishin bërë këtë, prifti i KOM-KO e kishte sulmuar atë verbalisht.

Komuniteti Bektashian (Tetovë) vazhdoi të kundërshtonte pretendimet e BFI-së për pronësi të plotë dhe planet e saj për të rinovuar me ndihmë turke kompleksin Harabati Baba Teqe që Komuniteti Bektashian (Tetovë) e përdor si selinë e tij. Për këtë qëllim, i dërgoi një letër Kryeministrit të përkohshëm Spasovski. Përfaqësuesit e Komunitetit Bektashian (Tetovë) vazhduan të shprehin shqetësimin se rinovimi i kompleksit do t'i zhvendoste ata plotësisht nga kompleksi. Komuniteti Bektashi (Tetovë) nuk mund të pretendonte pronësinë e kompleksit sepse grupi mbeti i paregjistruar. Deri në fund të vitit, projekti i rinovimit ishte në pritje të përfundimit të studimeve të fizibilitetit.

Media raportoi disa incidente të vjedhjes nga, dhe qeveria raportoi një incident vandalizmi kundër varrezave ortodokse, krahasuar me 12 akte vjedhjeje ose vandalizmi të vendeve ortodokse në 2019. Në janar, policia njoftoi se individë të panjohur kishin çmontuar dhe kishin vjedhur ulluqet e bakrit nga një xhami në qendër të qytetit të Gostivarit, në pjesën perëndimore të vendit. Në Prill, KMBFGR dënoi përdhosjen e varrezave ortodokse në zonën Kamnik të Shkupit dhe u kërkoi autoriteteve të gjejnë dhe ndjekin penalisht autorët e krimit. Hetimi i incidentit kishte vijuar deri në fund të vitit.

Në shkurt, KOM-KO i dërgoi një letër kreut të partisë politike Integra duke protestuar kundër shfaqjes së një kisha të KOM-KO në sfondin e një reklame politike. Në korrik, Komuniteti Hebre lëshoi një njoftim për shtyp duke kërkuar që partitë politike të mos përdorin varrezat dhe shenja hebreje në reklamën e fushatës politike.

Në dhjetor, Komiteti i Helsinkit në vend regjistroi 38 incidente të gjuhës së

urrejtjes me elemente fetare gjatë vitit, krahasuar me tetë në vitin 2019.

Në janar, Komuniteti Hebre dhe Fondi i Holokaustit së bashku ndanë një postim në mediat sociale duke dënuar gjuhën e urrejtjes dhe komentet antisemitike. Ata u bënë thirrje qytetarëve, partive politike dhe institucioneve të refuzojnë retorikën e tillë dhe në vend të kësaj të përqafojnë kulturën e respektit duke marrë pjesë në përkujtimin dhe edukimin rreth Holokaustit. Në maj, Komuniteti Hebre raportoi tek autoritetet postime të shumta antisemite dhe gjuhë të urrejtjes nga një grup në Facebook i quajtur Ninurta Maqedoni. Në një postim më 12 maj ky grup thotë, "Shpirtrat e Hebrenjve janë shtëpitë e demonëve" dhe u kërkoi personave t'i shmangnin ato sepse ishin "një murtajë universale", dhe më tej i quan "të ndyrë, mizorë dhe çnjerëzorë". Hetimi ishte në pritje në fund të vitit.

Fondi i Holokaustit, i cili është një OJQ, vazhdoi të punojë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në një projekt për trajnimin e mësimitdhënësve për t'i mësuar nxënësit e shkollave të mesme për Holokaustin dhe historinë hebraike. Gjatë vitit, Fondi i Holokaustit mbajti katër seminare në internet për këtë qëllim.

Në Mars, Qendra Përkujtimore e Holokaustit hapi një ekspozitë të përhershme miliona dollarëshe në përkujtim të hebrenjve në vend dhe 7,148 hebrenjve të dërguar në kampin e vdekjes në Treblinka gjatë Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, ekspozita mbeti e mbyllur për publikun për pjesën më të madhe të vitit për shkak të kufizimeve të KOVID-19. Si në vitet e mëparshme, qendra zhvilloi programe arsimore të Holokaustit në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, deri në vendosjen e kufizimeve të KOVID-19.

Seksioni IV. Politika dhe angazhimi qeveritar i Shteteve të Bashkuara

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës zhvilluan takime me përfaqësues të qeverisë, përfshirë Ministrin e Brendshëm Oliver Spasovski, Ministren e Drejtësisë Renata Deskoska dhe Zëvendës Kryeministrin për Çështjet e Evropiane Bujar Osmani, për të diskutuar çështje të lirisë fetare dhe tolerancës, siç është bashkëpunimi i përmirësuar ndërfaqetare dhe respektimi dhe trajtimi i barabartë i grupeve fetare nga qeveria.

Ambasadori diskutoi mbi tolerancën ndërfaqetare dhe bashkëpunimin me krerët fetarë dhe rëndësinë e dialogut të hapur me grupet e besimit gjatë takimeve zyrtare dhe joformale. Në shkurt, Ambasadori u angazhua me një grup udhëheqësish fetarë dhe të shoqërisë civile nga KOM-KO, BFI, Komuniteti Hebre, Komuniteti Bektashian (Tetovë), Metodistët Ungjillorë dhe udhëheqësit e shoqërisë civile të cilët kishin marrë pjesë në një program shkëmbimi të SH.B.A. për të diskutuar lirinë fetare, respektin për shumëllojshmërinë, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe rëndësinë e respektit për larminë fetare.

Zyrtarët e ambasadës u takuan me udhëheqësin e BFI Fetahu dhe Kryepeshkopin e KOM-KO Stefan për të diskutuar çështje të lirisë fetare, duke përfshirë përshtypjen që lë qeveria se favorizon grupe të caktuara fetare.

Ambasada ka postuar 12 mesazhe të ndryshme në mediat sociale lidhur me lirinë fetare duke arritur mbi 62,000 ndjekës. Temat përfshinin Mëngjesin vjetor të Lutjeve të SH.B.A.-së, shpalljen e Ditës së Lirisë Fetare nga Presidenti amerikan, si dhe një mesazh në lidhje me rolet e rëndësishme që luajnë bashkësitë fetare për të ndihmuar kongregacionet e tyre dhe anëtarët e tyre më të prekshëm të përballen me sfidat që u shfaqën si pasojë e pandemisë të KOVID- 19.